



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me banorët dhe përfaqësuesit e fshatrave të rajonit të Lluzhanit, mbajtur më 13 qershor 2018

Takimi filloi në orën 17:05, dhe u mbajt në SHFMU "Afrimi e Fahriu" në Fshatin Lluzhan.

Takimin e hapi dhe kryesoi z.Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Pjesëmarrës nga Ekzekutivi i Komunës ishin z.Vezir Januzi drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, z.Durim Salihu drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, z.Agim Blakqori drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe z.Ramadan Zymeri nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë të evidentuar dhe nënshkruar në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Çështja: Dëgjim buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2019/01

Isuf Latifi, drejtor i DBF, e hapi takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, dhe shtoi, Komuna e Podujevës është në proces të hartimit të buxhetit të Komunës për vitin mbi bazën e Qarkores Buxhetore 2019/01 të Ministrisë së Financave si dhe projeksionet fillestare të projekteve kapitale për 2020/2021, që do të përfshihen në Projektbuxhetin e Komunës, proces i cili parashihet t'i nënshtrohet edhe konsultimeve me publikun që qytetarëve t'iu mundësohet të paraqesin nevojat dhe prioritetet e investimeve në secilin lokalitet, me qëllim që në planifikimet buxhetore të hyjnë projektet që janë me interes të tyre.

Buxheti i Komunës për vitin 2019 pritet të jetë rreth 22 milionë euro, nga të cilat rreth 7 milionë euro do jenë për investime kapitale ku prej tyre rreth 400,000.00 € ndahen për mbështetje – subvencionim në fusha të ndryshme si bujqësi, blegtori e të tjera.

Pra sot kemi të bëjmë kërkesat dhe nevojat e juaja të cilat do t'i paraqitni ju si përfaqësues apo si banorë të fshatrave të kësaj ane, andaj pa humbur kohë mund të fillojmë.

Artan Maloku - nga fshati Lluzhan, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rr."Ana Mali" e cila gjendet në hyrje të fshatit Lluzhan dhe e cila lidhë këtë fshat me fshatin Godishjank.

Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, theksoi, meqë në mandatin e kaluar kam qenë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, jam në rrjedha rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë me investimet kapitale përkatësisht asfaltimin e rrugëve. Këtë e ndërlidhi me kërkesën e parafolësit, sepse sa jam në dijeni ajo rrugë është private andaj nuk ka mund të asfaltohet sepse ne si Komunë paraprakisht kemi kërkuar nga qytetarët që në raste të tilla fillimisht duhet të sillen një dokument nga Noteri me të cilin palët deklarojnë se atë rrugë e kthejnë nga private në publike e pastaj të njëjtën ta bartin në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë. Pra kjo është procedura në rastet kur në prona private hapen rrugë dhe për to kërkohet të asfaltohen.

Fadil Bici, përfaqësues i fshatit Godishjak, theksoi, për fshatin të cilin e përfaqësoj, unë i kam paraqitur disa kërkesa në formë të shkruar në Drejtorinë e Urbanizmit dhe të njëjtat do t'i ripërsëris,

Gjithashtu kërkojmë edhe sanimin e dëmeve të shkaktuara në pronë private nga Kompania gjatë punimeve për zgjerimin e Lumit.

Sejdi Kamberi, përfaqësues i fshatit Majac, paraqiti kërkesat si në vijim:

-asfaltimi i rrugës së Bugurdollit rreth 500 m, duke përfshirë edhe rrugën me gjatësi rreth 800 m, që lidhet me këtë rrugë (e cila shpie tek Xhema)

-asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në anën e poshtme të fshatit, me theks rr. "Isa Idrizi" dhe rr. "Tefik Gashi"

-vazhdimi i ndërtimit të ujësjellësit tek Lagja e ashtuquajtur Livadhegjit

Hakif Syla, nga fshati Shakovicë, paraqiti kërkesën për asfaltim të rrugës e cila gjendet afër Bajnës - në anën e djathtë. (rrugë private e hapur nga vet familja)

Bajram Tullari, përfaqësues i fshatit Tërnavë, paraqiti kërkesat si në vijim:

-ndërtimi i kanalizimit në Lagjen Tullari dhe asfaltimi i rrugës në gjatësi rreth 400 m.

-asfaltimi i rrugës nga Lagja Podvorica deri tek Lagja Vllahitë

-rregullimi me zhavorr i rrugës në gjatësi rreth 700-800 m, nga Lagja Mehana deri tek Lagja Deshishkët

Bilall Kaçiu, - nga fshati Lluzhan, paraqiti kërkesën për ndërtimin e kanalizimit rreth 250 m, në rrugën e cila gjendet afër "Sharrës" në anën e majt të rrugës kryesore në drejtim të Orllanit.

Abdullah Çunaku, përfaqësues i fshatit Llugë, si fshat kemi paraqitur kërkesa për asfaltimin e disa rrugëve dhe rrugicave të fshatit që në total janë rreth 500 – 600 m, mirëpo disa prej tyre janë kthyer negativ nga ana e Drejtorisë përkatëse, për të cilat jeni në dijeni, dhe të njëjtat mbesin sërish kërkesa të fshatit, duke ia bashkëngjitur edhe kërkesat si në vijim;

-t'i bëhet kërkesë Ministrisë përkatëse për renovimin e shkollës së fshatit sepse është në gjendje të mjerueshme dhe mendoj se nuk ka kushte për mësim në atë objekt.

-vazhdimi i ndërtimit të fushës së sportit në hapësirën e shkollës, e cila është filluar vitin e kaluar por që nuk është përfunduar.

-marrja e masave për lirimin dhe parandalimin e uzurpimit të oborrit të shkollës, ngase vazhdimisht shohim se është duke u zvogëluar me ndërtime, rrethoja etj.

-vëmendje më e madhe sa i përket ndarjes së subvencioneve për aplikuesit e fshatit Llugë.

-zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në pjesë të ndryshme të fshatit.

Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, sa jam në dijeni një numër i madh i rrugëve të fshatrave janë në listë për asfaltim në këtë vit dhe do të kryhen, procedura e tenderimit është në përfundim e sipër, andaj është mirë të interesoheni edhe ju përfaqësuesit e fshatrave në mënyrë që të mos përsëriten të njëjtat kërkesa.

Shaban Menxhiqi, - nga fshati Lupç i Epërm, paraqiti kërkesat, si në vijim:

-vazhdimi i ndërtimit të kanalizimit të ujërave të zeza, i cili ka filluar në vitin e kaluar.

-vendosja e të gjitha tabelave të emrave të rrugëve të fshatit, sepse nga 6 rrugë të fshatit janë vendosur vetë 4 tabela.

-zgjerimi dhe renovimi me zhavorr i rr. "Hasan Shabani" në gjatësi rreth 1 km,

Fehmi Bajraktari, përfaqësues i fshatit Batllav. paraqiti kërkesat si në vijim:

-kërkesë për asfaltim, zhavorr, dhe kanalizim në 4 Lagje të cilat janë përtej Xhamisë së fshatit.

-pyetje rreth ndërtimit të kanalizimit në fshatin Batllavë përkatësisht ndërtimit të kolektorit, a do të ndërtohet edhe një kolektor tjetër sepse vetëm një po ka probleme për mbledhjen e të gjitha ujërave të zeza.

-ndërtimi i rrethojave, fushës së sportit dhe rregullimi i oborrit të shkollës së re të ndërtuar në vitin e kaluar.

Sabit Zeka, përfaqësues i fshatit Metergoc, fillimisht shtroj pyetje, a ka në plan Komuna të investoj ndonjë projekt në fshatin Metergoc.

-kërkesë për asfaltimin e rrugës kryesore të fshatit, të paktën të fillohet në këtë vit ose në vitin e ardhshëm.

Isuf Latifi, drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, ne si Komunë vazhdimisht kemi bërë investime në të gjitha fshatrat pa dallime varësisht nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, ashtu siç janë bërë investime edhe në fshatin Metergoc. Jemi në dijeni për kërkesën e Juaj për asfaltim të rrugës kryesore, mirëpo të jemi të kurtarë sepse ajo rrugë ka një kosto të madhe, mos të them të papërballueshme nga buxheti i Komunës, mirëpo si do që të jetë shpresoj se ajo rrugë do të filloj të asfaltohet. Vlen të ceket se Kryetari i Komunës disa herë ka dërguar shkresa-kërkesa në Ministri të ndryshme për financimin e asaj rruge por që deri më tani nuk kemi diçka konkrete.

Imi Bunjaku, paraqiti kërkesat, si në vijim;

-asfaltimi i rrugës në afërsi të varrezave në gjatësi rreth 700 m.

-vazhdimi i ndërtimit të kanalizimit i cili është kryer për një pjesë të fshatit por që nuk ka pas mbikëqyrje të punimeve, pastaj është prerë rruga në disa vende dhe nuk është sanuar nga ana e kompanisë, andaj kërkojmë të përcillen punimet në këtë projekt.

Murat Bajrami, përfaqësues i fshatit Barainë, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rr. "Behram Bislimi", asfaltimin e rrugës në Lagjen Arifaj dhe asfaltimin e rrugës tek Brryli i Xhakalivë.

Shaip Hoxha, - nga fshati Penuhë, paraqiti kërkesat si në vijim:

-zgjjerimi i Lumenjve nga rruga e fshatit Konushevc e tutje

-asfaltimi i rrugës tek Lagja Hoxha

Xhemajl Bunjaku, - nga fshati Sallabajë, paraqiti kërkesat, si në vijim:

-meremetimi i rr. "Fronti" dhe rr. "Fejzullahu", ngase siç tha, janë dëmtuar shumë nga të reshurat,

-shtrirja e ujësjellësit në një pjesë të fshatit, në gjatësi rreth 2 km.

Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, theksoi, Komuna e Podujevës si çdo vit tjetër paraprak që ka zhvilluar dëgjime të tilla buxhetore dhe ka marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, edhe tani po e vazhdojmë të njëjtën gjë sa i përket procesit të përgatitjes së projektbuxhetit të Komunës për vitin 2019 dhe projeksionet për dy vitet e ardhshme, ku pjesë e buxhetit janë edhe subvencionet në bujqësi dhe fusha tjera të ngjashme. Dëgjova me vëmendje të gjithë parafolësit, mirëpo deri tani nuk dëgjova ndonjë kërkesë, projekt, ide ose propozim në sektorin e bujqësisë që mund të themi lirshëm se është sektori më i rëndësishëm për zhvillimin e Komunës së Podujevës si në punësim, të ardhura, etj, andaj kërkoj të bëhen kërkesa, të jepen ide, rekomandime dhe propozime konkrete sa i përket bujqësisë si një sektor i zhvillimit.

Sa i përket ndarjes së subvencioneve, ju sqaroj se Komuna e Podujevës nga viti 2012 ka miratuar Rregulloren përkatëse me të cilën rregullohet në mënyrë të qartë e gjithë procedura e ndarjes së subvencioneve në bujqësi dhe në fusha tjera, rregullore e cila zbatohet në përpikëri nga ana e zyrtarëve Komunal.

Për vitin 2018 kemi disa fusha të cilat i subvencionojmë, (jep sqarime për projektet përkatëse), prandaj ju ftoj të aplikoni dhe të zhvilloni bujqësinë dhe sektorët tjerë, sa më shumë që është e mundur në këtë pjesë të territorit të Komunës.

Muhamet Podvorica, - nga fshati Tërrnavë, paraqiti kërkesat, si në vijim:

-ndërtimi i fushës sportive tek shkolla

-asfaltimi i rrugës që lidh Lagjet Kuleta dhe Nelakt

-marrjen e masave dhe ndalimin e hedhjes së mbeturinave në vende të ndryshme, si dhe kushtëzimin e disa familjeve që të kyeçen në rrjetin e kanalizimit fekal.

Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, sa i përket menaxhimit të mbeturinave, marrjen e masave për ndalimin e hedhjes së mbeturinave në vende të ndryshme si dhe kyçjes së të gjitha familjeve në rrjetin e kanalizimit, ne kemi menduar së bashku me z.Hamdi Jahën

drejtorin e DPUMM të thërrasim një takim të gjithë përfaqësuesit e fshatrave dhe të gjejmë një zgjidhje sa i përket këtij problemi. Pra do të fillojmë diçka më serioze për ruajtjen e ambientit.

Naim Mehmeti, nga fshati Halabak, paraqiti kërkesat si në vijim:

-ndërtimin e rrethojave të oborrit të shkollës

-ndërtimin e fushës së sportit në hapësirën e oborrit të shkollës

-vazhdimi i ndërtimit të kanalizimit edhe në Lagjet Kosumi, Salihu dhe Zeqiri.

-gjithashtu kërkoj të kushtëzohet përfshirja e banorëve në rrjetin e menaxhimit të mbeturinave për shkak se po ka hedhje të mbeturinave vend e pa vend çka edhe po shkakton ndotje të ambientit. Po ashtu kërkoj edhe kyçjen në kanalizimin e ujërave fekale të disa familjeve të cilat edhe pse është ndërtuar kanalizimi ende nuk janë kyçur pa ndonjë arsye.

Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, po ndërlidhem me parafolësin, sa i përket mbeturinave është mirë të ketë bashkëpunim mes përfaqësuesve dhe banorëve të fshatrave me organet dhe shërbimet kompetente të Komunës dhe të tjera, në mënyrë që të ketë një vetëdijësim sa më të madh të qytetarëve sa i përket kësaj çështjeje. Madje bëjë thirrje të ketë lajmërim nga ana e vetë qytetarëve të cilët shohin – vërejnë dikë që hedhin mbeturina në vende të palejueshme apo që nuk janë të kyçur në rrjetin e kanalizimit, gjë me cila është në interes të përgjithshëm.

Nuhi Selimi, përfaqësues i fshatit Orllan, paraqiti kërkesat, si në vijim:

-asfaltimin e rrugës në drejtim të shkollës së fshatit.

-ndërtimin e fushës së sporteve në oborrin e shkollës

-rrenimi i objektit të vjetër të shkollës

-ndërtimin e trotuarit nga shkolla deri tek ish objekti i kooperativës bujqësore

-rregullimi i rrugës rreth 2 km, me zhavorr në drejtim të familjes Zukaj

-asfaltimi i rrugës në Lagjen e Jasharëve.

Nuredin Hyseni, përfaqësues i fshatit Bellopojë, theksoi, unë në emër të fshatit kam paraqitur kërkesat konkrete me shkrim të cilat janë në Drejtorinë përkatëse dhe të njëjtat kërkoj të realizohen, mirëpo atyre kërkesave iu bashkëngjiti edhe kërkesat, si në vijim:

-riparimin e fushës sportive

-asfaltimi i rrugës rreth 1300 m, Lagja Rudari

-rregullimi me zhavorr i rr. "Bregu i Bareve"

-ndërtimi – riparimi i tri (3) urave në fshat

Arsim Arifi, nga fshati Barainë, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës në Lagjen Arifaj, për të cilën tha se hartuar dhe dorëzuar në Komunë projekti për këtë rrugë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për diskutime dhe paraqitje të kërkesave, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave z.Isuf Latifi falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe dhënie të kontributeve të tyre sa i përket paraqitjes së nevojave të banorëve të fshatrave të këtij lokaliteti, duke siguruar ata që të gjitha këto kërkesa dhe propozime do të diskutohen dhe analizohen nga Ekzekutivi i Komunës – Drejtoritë përkatëse dhe të gjitha ato që janë të arsyeshme dhe që mund të mbulohen me buxhet do të merren parasysh nga ana e Komunës në dokumentin final të buxhetit që do të propozohet për miratim deri në fund të muajit shtator.

Takimi përfundoi në orën 18:35

Procesverbalin e mbajtën:

Sabedin Namani

Enis Sheholli

**Podujevë,
13 qershor 2018**

**Drejtori i DBF
Isuf latifi**